



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 436/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve mbi rrugët publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë subjektit politik Partia e Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë i shqiptohet dënim i gjelbë në vlerë prej 2050 (dymijë e pesëdhjetë ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 02.11.2013, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën pretendohet se me datën 02.11.2013, në Rrugën “Isa Kastrati” te udhëkryqi i Velanisë në Prishtinë rreth orës 12:30, aktivistët e LVV kanë vërejtur se anëtarë të subjektit politik PDK kanë vendosur banerin e kandidatit për kryetar komune nga ky subjekt Agim Çeku mbi rrugë publike, dhe po ashtu ky poster është vendosur në këtë datë duke ditur se është heshtje zgjedhore. Andaj veprimi i tillë i vendosjes së banerit mbi rrugë publike është në kundërshtim me dispozitat e nenit 33, pika b të LZP-së si dhe dispozitat e nenit 3.4 të Rregullores 11/2013 të KQZ-së. Ndërsa shkelja tjeter e këtij subjekti është vendosja e materialit zgjedhor në periudhën e heshtjes zgjedhore siç është paraparë në nenin 7, pika b) të Rregullës zgjedhore 11/2013, neni 8, pika f) e Rr.Z 13/2013 dhe nenit 36, pika b) të LZP-së pretendohet në ankesën e këtij subjekti.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë dy fotografie.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 03.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.11.2013, në ora 19:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë të pa baza lidhur me shkeljet e rregullave të përcaktuara në LZP dhe Rrregullave zgjedhore. Ata shtuan sipas të dhënavë që posedojnë nga terreni, personat e panjohur e kanë bërë një veprim të tillë dhe nga momenti i njoftimit për rastin në fjalë menjëherë është intervenuar dhe është hequr baneri i kandidatit për kryetar të Prishtinës nga radhët e PDK-së. Poashtu, në këtë gjë thuhet se individ të caktuar që nuk janë anëtar të PDK-së i kanë keqpërdorur simbolet e PDK-së duke i vendosur ato në vende të palejuara me qëllim të dëmtimit të PDK-së dhe në raste të tilla PDK-ja ka intervenuar dhe ka

hequr simbolet e veta, përgjigjes në ankesë i janë bashkangjitur edhe fotografi me te cilat dëshmohet evitimi i shkeljes së supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik PDK ka vendosur poster mbi rrugë publike në Rr. "Isa Kastrat" tek udhëkryqi i Velanisë në Prishtinë, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe po ashtu i njëjti subjekt politik ka përsëritur në këto zgjedhje shkeljen e të njëjtës natyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartçekura konstatoi se subjekti politik PDK ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parashev se është e ndaluar të vendosen posterat në apo mbi rrugë publike, duke pasur parasysh se nga ana e subjektit politik PDK është larguar baneri në fjalë , menjëherë pas marrjes së kërkesë për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në përgjigje të ankesës, e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 436/2013 më datën 04.11.2013.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.